



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura III
Sesioni vjeshtor

Kryesia e Kuvendit
P-121
Prishtinë, më 5 tetor 2010, në orën 11:00
Ndërtesa e Kuvendit, salla C-301

PROCESVERBAL

I MBLEDHJES SË KRYESISË SË KUVENDIT, TË MBAJTUR MË 5 TETOR 2010

Në mbledhje morën pjesë: Jakup Krasniqi, kryetar i Kuvendit, Xhavit Haliti, Sabri Hamiti, Nexhat Daci, Naim Maloku, Eqrem Kryeziu, Ibrahim Gashi, Slllobodan Petroviq dhe Numan Baliq, anëtarë të Kryesisë;

Nga grupet parlamentare: Ramë Buja, Ismet Beqiri, Ibrahim Makolli, Ardian Gjini, Lulzim Zeneli dhe Xhezair Murati.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

Nga Kabineti i kryetarit të Kuvendit: Mehmet Hajrizi, Eshref Vishi, Ismet Hajrullahu dhe Skënder Reçica.

Nga Administrata e Kuvendit: Daut Beqiri, Xheladin Hoxha, Shefki Shoshaj dhe Sherif Konjufca.

Nga Zyra e Presidentit, Lumniye Murati,
Nga ZCN, Blerta Bejtullahu,
Nga OSBE, Floriana Shala dhe
Nga NDI, Shefki Kastrati.

Mbledhjen e drejtoi **Jakup KRASNIQI**, kryetar i Kuvendit.

Kryetari hapi mbledhjen dhe i njoftoi të pranishmit me propozimin e rendit të ditës, si dhe me materialet e shpërndara për këtë mbledhje.

Kryesia, me propozimin e kryetarit, miratoi këtë:

R e n d i t e

1. Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes së Kryesisë, të mbajtur më 28 shtator 2010,
2. Propozimi i rendit të ditës për mbledhjen plenare të radhës,

1. Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 28 shtator 2010

Procesverbali i mbledhjes së Kryesisë, të mbajtur më 28 shtator 2010, u miratua pa vërejtje.

2. Propozimi i rendit të ditës për mbledhjen plenare të radhës

Kryesia, pasi shqyrtoi përgatitjet e nevojshme për secilën pikë, veç e veç, me pëlqimin e kryetarëve të grupeve parlamentare, vendosi që mbledhja e Kuvendit të mbahet më 7 tetor 2010, me këtë

R e n d i t e

- 2.1 Koha për deklarime jashtë rendit të ditës,
- 2.2 Koha për pyetje parlamentare,
- 2.3 Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes plenare të mëparshme,
- 2.4 Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03-L-037 për dokumentet e udhëtimit,
- 2.5 Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për qasje në dokumente publike,
- 2.6 Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për mbrojtjen e konkurrencës,
- 2.7 Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për energjinë,
- 2.8 Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për energjinë elektrike,
- 2.9 Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për Rregullatorin e Energjisë,
- 2.10 Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për tatimin në pronën e paluajtshme,
- 2.11 Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për themelimin e sistemit për sigurimin e depozitave për institucionet financiare në Kosovë.
- 2.12 Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për regjistrimin e popullsisë, të ekonomive familjare dhe të banesave.

Në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, Ramë Buja, propozoi që për mbledhjen e radhës të radhitet edhe Projektrezoluta për bisedimet Kosovë-Serbi. Kryesia, pasi diskutoi lidhur për propozimin e kryetarit të Grupit Parlamentar të PDK-së, vendosi që kjo çështje të shtyhet për mbledhjen tjetër të radhës.

Kryetari e deklaroi të mbyllur mbledhjen e Kryesisë në orën 11:25 minuta.

Kryetari i Kuvendit

Jakup KRASNIQI

Procesverbalin e hartoi

Divizioni për Çështje Plenare dhe Procedurale